VENDIM
Nr.12, datë 28.1.2005

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR EKSPERTËT KONTABËL TË AUTORIZUAR TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT

Në mbështetje të shkronjave "e" dhe "k" të pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 20.7.2004 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve" dhe të neneve 71, 72, 73, 74, 75 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 "Për sigurimin, risigurimin dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime", Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores "Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit" sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Kjo rregullore t'u dërgohet të gjitha shoqërive të sigurimit për zbatim.
3. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim hyn në fuqi më 28.1.2005

KRYETARI I KËSHILLIT
TË AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Burbuqe Riba